


AGIM SHEHU

BIBLIOTEKA

SSH-1

Sh 30



POEZI

arkitektura e zemres

8JA-1
5430

AGIM SHEHU

**ARKITEKTURA E
ZEMRËS**



54050

- Tiranë 1994 -

FRYMA E SHTËPISË NË FSHAT

Hyra në shtëpinë e lindjes
që rrinte pa njeri brënda.
Nëpër trarët e shtëpisë
si mëndafsh i butë ajri
endej frymë e gjyshes sime
që iku kur s'kisha lerë.
Te hiri shuar në vatër
flinte jeta e këputur
e aq brezave nga fisi.
Nëpër dhomat pa njeri
venë e vinë pa biseduar
ata që s'janë më në jetë.

Nëpër pllakat e oborrit
bari që njeri s'e shkelte
çelte për inat të vdekjes.
Prilli mbi degët e ftoit
ulte hënën në çdo lule.
Zogu që ulej pa frikë
në parvazin e dritares,
dyerve që nuk lëviznin
u kërkonte kalamanët.
Isha larg e isha burrë.
Në dhomat me sy të shqyer
muret donin frymë njeriu
të ngjiteshin ku qenë çarë.
Macja e vetme e gjitones
në oborr ecte pa qejf
se s'shihte njeri ta trëmbte.

Një gozhdë ngulur në mur
ndryshkej nga malli për rroba.
Rezja që hynte në dhomë
nga të çarat e çatisë
kontrollonte herë pas here
mos dikush që ngjallur brënda.
Vërshëlleva pak me vete, -
s'di ç'u zgjua brënda dhomës
dhe muret mësuar heshtur
bubullinë për të rënë.

UDHËT NË PLLAJË TË MALIT

-shqiptarët -

Udhët te pllaja në zall
mblidhen kryq tërthor nga shpati.
Secilën nga to në mal
një kokë me vete e hapi :

Atë udhë të sertë tërthore
një malsor nisur për sherre
e hapi me majë të shollëve
nëpër shkëmb e ferrë pas ferre.

Tjetrën udhë të butë mes bari
si me vijë të lëmuar,
e hapi ëmbël stanari
kur kthehej në fshat te gruaja.

**Atë rryp mbi zall të bardhë
e çau dikush drejt shkrepit
(larguar nga udhë e parë
meqë e kish hapur tjetri).**

**Veç e veç si karaktere,
udhë e dytë mënjanë së parës
(Te gryka në buzë humnere
bëhen një përballë ujvarës).**

E VJETRA URË E FËMIRISË

Urë e fëmirisë së brishtë !

**Na shihje që nga larg tek vareshim sovranë :
kalorës - zbathur,
përmbi brekë këmishët.
me nga një shkop në dorë si jataganë.**

**Në xhëp pak bukë. Erë qepe e rigoni.
Trupa të lehtë fëmijësh të cfilitur.
Tek hidheshim me kokë,
në ajër riprodhonim
harqet e këmbëve që të qenë mbytur.**

**Mbi një kaçubë rrobat peng t'i linim .
Dielli mbi ujë dridhej si monedhë.
Ne zgjateshim "me pushë" ta cingnim
Po në pëllëmbë
s'na ndënji asnjëherë !**

**Rrinim mbi pllaka posi zogj të lagur.
Shihnim me dhimbje
pellgun tharë nga vapa !
Ujin e flokëve ia dhuronim avull
një reje varur mbi ujrat e pakta.**

LIBRI I PARË NË VITRINË.

**Një cep vitrine në librari
zuri libri im i parë dikur.
Volumet e trasha shikonte përbri
si gjimnazistja
komisionin në maturë !**

**Sovrane, me zymti fytyre
rrinin volumet me lavditë mbi supe.
As e vunë re
se në këmbët e tyre
hyri gjimnazistja ime e turpshme.**

**Me modernët - viganë
s'i shkante nër mënd të ngrëjë gotë një grimë.
Kokulur, kërkonte t'u rrinte pranë
këmbanave të tyre
t'u shtojë një psherëtimë.**